

AKBN

Veprimtaria e AKBN-së, orientohet dhe organizohet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, legjislacionit në fuqi, dhe programit të qeverisë në fushën e burimeve natyrore.

Misioni i AKBN konsiston në zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik si dhe promovimin e burimeve natyrore.

Aktiviteti minerar

Shqipëria shquhet për pasuritë e veta nëntokësore, sidomos për pasuritë minerare. Pjesa më e madhe e tyre janë shfrytëzuar. Pasuri të mëdha vendi ynë ka në gurët dekorative dhe ofiolitike dhe ka rezerva prej disa qindra milion m³ si dhe ofrohen mundësi mjaft të mira që të rritet prodhimi i tyre.

Tendenca e prodhimit të mineraleve në vendin tonë është gjithmonë e në rritje. Vendi ynë gjithashtu ka edhe rezerva të mëdha minerare si Kromi-34.9 milion ton, Fe-Ni dhe Ni-Si 340 milion ton; gëlqerorë më shumë se 500 milion m³ rezerva gjeologjike etj. Në fushën minerare janë kryer investime për vitin të mëdha 2012 me të ardhura rreth 50.4 milion USD. Deri në Maj 2013 janë aktive 648 leje minerare shfrytëzimi

Hidrokarburet: Potenciali i vendit

Shqipëria është një vend hidrokarbur mbajtës, i cili ka rreth një shekull që prodhon sasira naftë dhe gaz. Deri sot, janë në fuqi shtatë Licensë Marrëveshje Hidrokarbure (LM), mbi bazen e të cilave janë lidhur Marrëveshjet Hidrokarbure (MH) respektive për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet ekzistuese të naftës midis kompanisë Albpetrol dhe kompanive të huaja si më poshtë:

- Patos-Marinez - Bankers Petroleum;
- Ballsh-Hekalit - Stream Oil & Gas;
- Cakran-Mollaj - Stream Oil & Gas;
- Gorisht-Koculit - Stream Oil & Gas,
- Delvina - Stream Oil & Gas
- Kucova - Sherwood International,
- Visoka - Transoilgroup AG.

Kompanitë që kërkojnë naftë në territorin shqiptar, janë si më poshtë:

- Petromanas Albania GmbH;
- Capricorn Albania Ltd (Joni-5) det;
- San Leon Energy Plc. (Blloku i Durrësit) det;
- Bankers Petroleum Albania Ltd. (Blloku F) tokë;
- Emanuelle Adriatic Energy Limited (Blloqet 2,3,4) det;
- Stream oil and Gas;
- Sherwood international.

Ne vendin tone ekzistojne akoma blloqe të lira. Zhvillimi i operacioneve hidrokarbure behet i mundur si rezultat i nje legjislacioni specifik dhe mjaft efektiv ne kete fushe. Gjithashtu ne kete fushe ekziston dhe nje organizim institucional mjaft i pershtatshem.

Hidrocentralet ne vend

Pas miratimit të ligjit të koncesioneve në vitin 2006 dhe ngritjes të strukturave përkatëse, ju kushtua një vëmendje e madhe shfrytëzimit për prodhim energjie elektrike te resurseve ujore të vendit tone, duke dhënë me koncesion në formën e ofertave të pa kërkuara një pjesë të mirë të kaskadave ujore. Nga viti 2002 e deri me sot jane lidhur me METE 127 kontrata koncesionare per ndertimin e 371 hidrocentraleve, me fuqi totale 1.641 MW dhe prodhim vjetor 6.833 TWh

Nga tërësia e ketyre HEC-ve të vegjël rezultojnë:

32 HEC-e me kontratë koncesionare, me fuqi të instaluar 24,4 MW

16 HEC-e janë të privatizuar, me fuqi të instaluar 2,047 MW

22 HEC-e janë shtetërorë, me fuqi të instaluar 11,0 MW

Energjite e rinovueshme

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në bashkëpunim me METE dhe AKBN përcakton target-et e zhvillimit të burimeve të rinovueshme si dhe harmonizon kuadrin ligjor në përputhje me Direktivat e BE-së. Për Shqipërinë targeti i vendosur nga Komuniteti i Energjisë për burimet e rinovueshme është 39% të konsumit final të energjisë.

Mjaft kompani kanë përgatitur dokumentet e nevojshme për investime në energjinë fotovoltaike. Qeveria shqiptare në bashkëpunim me PNUD-in po punon për një projekt për promovimin e energjisë diellore në përdorimin e ujit të ngrohtë.

Energjia e Eres mund te shfrytezohej ne rajonet malore te pjeses veri-lindore ne zonat kodrinore te bregdetit, ne zona jugore dhe ne zonen jug-lindore. Ne zonen perendimore te vendit, pra ate bregdetare, rezultojne vende me interes per shfrytezimin e energjise se eres

Vendi aktualisht eshte ne nje faze te vleresimeve te potencialit te energjise gjeotermike.

AKBN ve në dispozicion të gjitha studimet dhe projektet në fushën për të cilën ju interesoheni. Ofrojmë konsulencë dhe asistencë teknike për të gjitha problemet që lidhen me nxjerrjen dhe përpunimin e të gjithë mineraleve të ngurta dhe të lëngshme.

Për çdo informacion më të detajuar ju lutem të vizitoni website tone www.akbn.gov.al si dhe të na kontaktoni në adresën e e-mail : info@akbn.gov.al